



Vrimat e Zeza të Kodit Zgjedhor



RAPORT MONITORIMI

Shkurt - Prill 2023






Përmbajtja:

Rëndësia e Kodit Zgjedhor	3
Ndryshimet e 2020-ës në Kodin Zgjedhor	5
Politikat e ndërmarra nga qeveria, krahasimi me premtimet elektorale	6
Investimet e projektuara në buxhetin e shtetit për 2023	8
Përmbledhje:	11
Rekomandime:	12
References:	13

Rëndësia e Kodit Zgjedhor

Zgjedhje të lira dhe të drejta janë simboli kryesor i demokracisë së një vendi. Për shtetet akoma në zhvillim apo politikat e të cilëve nuk janë akoma të mirëkonsoliduara, mbarëvajtja ose jo e procesit zgjedhor thekson edhe më tepër rëndësinë e këtij procesi, garancues të zbatimit të së drejtës së njeriut për të zgjedhur përfaqësuesit të tij. Sipas Kushtetutës¹ së Republikës së Shqipërisë, "çdo shtetas që ka mbushur 18 vjeç i garantohet e drejta e që të zgjidhet dhe të zgjedhë në ditën e votimeve". Për të siguruar më tej mirëfunksionimin e zgjedhjeve lokale ose vendore në Shqipëri në ndihmë të procesit vjen Kodi Zgjedhor dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Në një raport të "Our World in Data"² për shtetet me zgjedhjet më të lira dhe më të drejta për intervalin kohor 2005-2022, paraqiten sipas një indeksi vlerësues nga 1-10 pikë. Për vitin 2021, nga vendet e rajonit Shqipëria paraqitet në një pozicion të pranueshëm me 7 pikë, Mali i Zi 6 pikë, Maqedonia e Veriut 7 pikë, Kosova 9 pikë, Serbia 6 pikë, Bosnja dhe Hercegovina 6 pikë, Bullgaria 8 pikë, Rumania 9 pikë.



Source: Bertelsmann Transformation Index (2022)

OurWorldInData.org/democracy • CC BY


Më tej po të analizojmë në intervalin kohor 2005-2021 vlerësimin e procesit zgjedhor në rajonin e Ballkanit Perëndimor, të vendeve me statusin kandidat për në Bashkimin Europian apo potencial vërehen tendencat si në grafikun më poshtë.

Shtetet në progres për sigurimin e mbarëvajtjes së zgjedhjeve të lira dhe të drejta në rajon janë Kosova dhe Shqipëria, ndërkohë shtetet si Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina kanë pësuar rënie

¹ <https://klp.al/wp-content/uploads/2020/02/Kushtetuta-2017.pdf>

² https://ourworldindata.org/grapher/frë-fair-elections-bti?tab=chart®ion=Europe&country=ALB~OWID_KOS~MNE~MKD~SRB~BIH

graduale të indeksit për vitet e fundit. Rast pozitiv shfaqet ai i Republikës së Kosovës, i cili ndonëse një ndër shtetet më të reja në Europë, po garanton me integritet zhvillimin e proceseve te sakta zgjedhore.



Source: Bertelsmann Transformation Index (2022)

OurWorldInData.org/democracy • CC BY

Përsa i përket Shqipërise, aplikimi për anëtarësim në vitin 2009 dhe dhënia e statusit “Vend Kandidat” në 2014 kanë pasur impaktin e tyre në progression që paraqitet më lart. Një ndër kriteret që Shqipëria të merrte statusin vend kandidat lidhen me garantimin e zgjedhjeve të lira dhe demokratike. Si një shtet post-diktatorial por më vonë edhe aspirues për t’iu bashkuar Bashkimit Europian, monitorimet për procesin e dhënies së votes kanë qënë të shumta dhe periodike qoftë nga BE, institucione të pavarura, si dhe organizata kombëtare dhe ndërkombëtare.

Për periudhën 2005-2021 vërehen luhajtje të vogla në vite të caktuara si 2005-2007, 2009-2013 dhe 2013-2015. Duke vlerësuar raportet monitoruese dhe identifikimin e problematikave gjatë periudhave zgjedhore, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të marrë masa për ndërhyrjen, ndjekjen dhe ndëshkimin e tyre si dhe parandalimin në zgjedhjet e ardhshme. Moshfunktionimi i këtyre strukturave ose pasja e hapësiravë në legjislacion të cilat mund të keqpërdoren nga partitë politike për të krijuar avantazh në zgjedhje cënon në mënyrë direkte apo hera-herës indirekt një proces të drejtë e të ndershëm. Përqëndrimi i kompetencave më të mëdha dhe fuqizimi i KQZ-së në vitet e fundit ka ndikuar në stabilitetin e indeksit të afishuar edhe nga referencat e studiuesve më lartë, ndonëse periudhat zgjedhore në Shqipëri vazhdojnë të shoqërohen me shkallë të lartë riskueshmërie për problematika apo incidente.

Ndryshimet e 2020-ës në Kodin Zgjedhor

Zgjedhjet e 2019 konsistuan në një situatë krize politike dhe institucionale midis partive politike në vend. Marrja e vendimit për tërheqjen nga Kuvendi dhe mospjesëmarrjen në zgjedhjet lokale nga ana e Partisë Demokratike dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim ndikoi jo vetëm në krijimin e një trupe administrate zgjedhore të paekuilibruar politikisht, cënimin e zhvillimit të një procesi të drejtë por gjithashtu edhe në besueshmërinë e individëve tek fuqia e zgjedhjeve.

Duke marrë shkas nga zgjedhjet lokale të një viti më parë dhe ato vendore të 2017,

në qershor të 2020, Partia Socialiste, Partia Demokratike, Lëvizja Socialiste për Integrim dhe partitë e tjera opozitare paraqitën një draft³ me 31 ndryshime për Kodin Zgjedhor. Ky draft do vinte më tëpër në vemendje rolin e KQZ-së, fuqizimin e tij dhe vendosjen e partive politike para një kërkesëllogjrie më të madhe kundrejt këtij institucioni. Bazë e këtyre ndryshimeve do ishin çeshtjet më polemika më të mëdha për veprimtarinë politike dhe palët e përfshira, si procesi votimit, votuesit, logjistika, përfaqësuesit e institucioneve, përdorimi i fondeve publike, media etj.

Për të vazhduar më tej analizën dhe interpretimin e situatës korrente do ndalemi në nenin 91 të Kodit Zgjedhor 2020 të përditësuar.⁴

Sipas nenit 91 për "Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore", thuhet:

1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.

2. Në kuptim të këtij neni, "burime" quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, tëparashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Me përdorim të "burimeve njerëzore" kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore

³ <https://shqiptarja.com/lajm/31-ndryshimet-ne-kodin-zgjedhor-nga-rihapja-e-kutive-deri-tek-befimi-i-krjetareve-te-partive-se-nuk-do-blejne-votat>

⁴ <https://qbz.gov.al/preview/75122d2e-9ebc-45de-b0ea-b5efde2f6836>

kuptohejt gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimit, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim.

3. Gjatë fushatës zgjedhore ndalohet marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, me përjashtim të rasteve të përligjura. Konsiderohen raste të përligjura rastet kur lëvizja apo lirimi nga puna vjen si rrjedhojë e shkelleve, sipas legjislacionit përkatës, ose marrja në punë bëhet brenda strukturës dhe organikës në fuqi përpara fushatës zgjedhore nga institucioni apo enti publik në përmbushje të misionit të tij. Bëjnë përjashtim rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të paparashikuara që diktojnë marrjen në punë.

4. Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet qëparashikojnë rritjen e pagave, pensione, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore.

5. KQZ-ja nxjerr udhëzime të hollësishme për të përcaktuar përdorimin dhe shpërdorimin e burimeve publike.

Informimi i shtetasve shqipëtar mbi nenin 91 përben një rëndësi për nga ana e qasjes që kanë në komunitet nënçeshtjet e trajtuara dhe moslejimin e alokimit të burimeve publike për mbështetje ndaj subjekteve politike duke ndikuar kështu në premtimet elektorale dhe anshmërinë e padrejtë të individëve.

Politikat e ndërmarra nga qeveria, krahasimi me premtimet elektorale

Periudhat zgjedhore përkrijnë me marrjen e vendimeve për ndryshime dhe përmirësim infrastrukture, strategji dhe propozime për zbatimin e politikave të reja mbrojtëse të kauzave sociale apo ekonomike. Shpesh, këto ndërhyrje apo veprime, paraqiten nga subjektet politike edhe në formën e premtimeve elektorale. Muaji Maj i këtij viti përkon me zhvillimin e zgjedhjeve lokale në Republikën e Shqipërisë për 61 bashki të vendit. Ndonëse fushata

zgjedhore nuk ka nisur zyrtarisht, me publikimin e listave për kandidatët e bashkive, kanë nisur edhe aktivitetet e para për takime me banorë apo palët drejtëpërsëdrejti të interesuara.

Një element që ka tërhequr vëmendjen e publikut kohëve të fundit janë ndryshimet dhe projekt-planet e shumta të prezantuara nga qeveria, kryeministri i vendit apo përfaqësues të institucioneve publike brënda një intervali kohor të përafërt me fushatën zgjedhore. Lë hapësirë për tu diskutuar lidhja e këtyre projekt-planeve apo politikave të premtuara për tu zbatuar në nivel kombëtar me zgjedhjet lokale dhe impaktin që predispozohet të kenë në nivel më mikro dhe kompetencat bashkiake.

Në një mënyrë paksa më të përmbledhur premtimet dhe propozimet e bërë nga qeveria muajt e fundit të cilat janë shoqëruar me hije dyshimi nga qytetarët përsa i përket arsyeve të vërteta mbi publikimeve të tyre në këtë fashë kohore. Më poshtë gjeni disa prej tyre:

Mars 2023

- Premtim rritje pagash prej 50 mijë lekësh për mjekët specialistë në muajin Prill.
- Kredi të butë për shtëpi mjekëve specialistë çift. Pagimi i orëve shtesë. (Programi për të frenuar eksodin).
- Inagurimi i Spitalit të ri Shëndetësor në QSUT. I identifikuar nga kryeministri i Shqipërisë dhe ministrja e Shëndetësisë si investimi më i madh në shëndetësi në vlerën prej 17 mln euro.
- Alokimin dhe shpërndarjet drejt pensionistëve të taksës mbi eksportuesit e mëdhenj të energjisë përpos 5 mijë lekëve shtesë.
- Rritja e pagës së mësuesve, mjekëve dhe zjarrfiksave.
- Rritjen e pagës mesatare në vend në 900 euro.
- Marrja e vendimit për rritjen e pagës minimale nga 1 Prilli në 40 000 lekë.
- Ndryshimet në ligjin 22/2018 për strehimin social , Administrata Publike hyn në ligj si përfituese e Kredive të Buta, nëse humbet punën, humbet edhe kredinë e butë. Përcaktohen si prioritet në ligj, pa marrë parasysh shtresat në nevojë si jetimët, gratë e dhunuara etj.
- Hapja e thirjes për Skemën Kombëtare të Mbështetjes në Bujqësi (20 Mars- 11 Prill). Buxhet i shtuar me 3.3 miliardë lekë fonde.

Reformat e pagave apo politikat për zhvillimin e infrastrukturës shëndetësore, ekonomisë dhe bujqësisë pritet të kenë një impakt pozitiv në përmirësimin e standardit të jetesës dhe ekonomisë së vendi marre shkas edhe nga situata e veshtirë e vendit vitin e kaluar me rritjen e çmimeve dhe normën e lartë të inflacionit. Pavarësisht kësaj nga publiku i gjerë ka pasur diskutime nëse këto politika po përdoren edhe si instrumenta për fushatën zgjedhore. Në nenin

91, pika 4, Kodi Zgjedhor theksohet se "është e ndaluar propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensione, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore, 4 muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re". Në ballafaqimet me mediat⁵ kryeministri i vendit është shprehur se kjo predispozitë ligjore i përket zgjedhjeve vendore dhe jo atyre lokale, dhe vendi nuk mund të qëndrojë pa ndërmarre nisma që stimulojnë zhvillimin e vendit përgjatë periudhave zgjedhore.

*Në rastin e vendit tonë kryeministri i vendit është gjithashtu edhe drejtuesi i një ndër partive kryesore politike që kandidon për drejtuesit e bashkive. Në mënyrë të tërthortë prezantimi i këtyre reformave dhe ndryshimeve aktesh ligjore apo investimeve ngre lart edhe imazhin e partisë politike duke ndikuar ndoshta në pabarazi me partitë e tjera politike apo kandidatët respektiv.

Investimet e projektuara në buxhetin e shtetit për 2023

Një çështje që lidhet ngushtë me fushatat zgjedhore është keqpërdorimi i të ardhurave të shtetit për partitë politike, apo përdorimi i investimeve si pjesë e fushatave apo paketave të premtimeve elektorale. Shkak i të ardhurave të përfituara nga dogana, taksat doganore, TVSH në import etj, është bërë e mundur gjenerimi i të ardhurave në masën 98%⁶ krahasimisht me planin e paraqitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Shkak i kësaj rritje të ardhurash në buxhetin e shtetit ka ndikuar alokimi i më tepër të ardhurave në vitin 2023. Për 2023 u vendos buxheti i shtetit⁷ prej 485 366 milionë lekësh të ardhura; 540 864 milionë lekë shpenzime.

Open Data ka paraqitur në raportin e saj⁸ një tabelë me zërat e investimeve të përlloritura nga buxheti i shtetit për këtë vit. Rëndësia e këtyre të dhënave shërben për të kuptuar se ku ka qëndruar fokusi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë këtë vit, ndarja e buxhetit për investime për Bashki dhe lidhjen e mundshme me zgjedhjet lokale e premtimet e dhëna së fundmi nga qeveria mbi reformat e prezantuara.

⁵ <https://shajptarja.com/lajm/akuzat-se-riiti-pagat-per-fushate-politike-rama-analfabetizem-politik-kodi-flet-per-zgjedhje-te-pergjithshme-jo-lokale>

⁶ <https://financa.gov.al/perbledhje-e-performances-paraprake-12-mujore-te-te-ardhurave-dhe-shpenzimeve-2/>

⁷ <https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2023/01/CB23.pdf>

⁸ <https://ndiqparate.al/?p=18666>

Data.AI: Renditje Investime Publike sipas peshës së tyre në buxhetin e vitit 2023 (në mijë lekë), mbi 1 miliard lekë



Tabela 1: Renditje Investime Publike sipas peshës së tyre në buxhetin e vitit 2023

Burimi: MFE; Open Data Albania

Ashtu siç vërehet edhe në tabelën e mësipërme investimet me peshë më të madhe në buxhetin e shtetit rëndojnë mbi infrastrukturën dhe mbrojtjen e sigurinë. Dy nga projektet më të kushtueshëm për zhvillim infrastrukturë janë ai i Tunelit të Logarasë dhe Ndërtimi i sektorit rrugor Qukës- Qafë Pllaçë. Po këto projekte kanë qëndruar në pritje për shkak të faktorëve të ndryshëm (të papublikuar zyrtarisht) dhe rihien në plan për vitin 2023 me investime madhore. Vlen të përmendet që projekti i Tunelit të Llogarasë shpesh është cilësuar edhe si një levizje elektorale nga parti të ndryshme. Vemendja bie edhe tek zëra të tjerë si investime në infrastrukturën e konvikteve apo hapja e granteve për bashkitë, lëvizje tjetër gjithashtu që mund të përdoret apo të keqinterpretohet përgjatë periudhave zgjedhore.

Shpërndarja e buxhetit për investime në Bashkitë është një tjetër element që ja vlen të merret në analizim. Tirana, Berati, Mati, Pogradeci dhe Elbasani kryesojnë listën për peshën më të madhe të investuar si Bashki. Nga se u pa edhe më lartë vemendja qëndron tek infrastruktura, përmirësimi i saj dhe siguria. Krahas këtyre të dhënave qëndrojnë edhe qytetet si Gramshi, Delvina, Durrësi, Fushë- Arrëzi, Shkodra dhe Vora me 0 lekë investime publike nga buxheti i shtetit për 2023. Nuk ka informacion të mjaftueshëm për të thënë nëse kjo ndarje e të ardhurave të shtetit për investimet ne bashkitë e vendit lidhet me faktorin elektoral apo jo.

Data.AI: Bashkitë sipas Portofolit te Investime Publike Buxheti shtetit 2023, (në mijë lekë)




Tabela 2: Bashkitë sipas Portofolit të investimeve Publike Buxheti Shtetit 2023

Burimi: MFE; Open Data Albania

Përmbledhje:

1. Nga analizat dhe raporte të ndërmarra nga ndërkombëtarë, Shqipëria duket se po bën hapa progressive në garantimin e zgjedhjeve të drejta dhe demokratike. Përpos situatave problematike apo të papritura, ndërhyrjet në strukturat legislative dhe ndryshimet e fundit në Kodin Zgjedhor kanë kontribuar në përmirësimin e situatës.
2. Ndryshimet e 2020 në Kodin Zgjedhor i përkasin monitorimit dhe rregullimit të procesit zgjedhor vendor, duke lënë hapësirë për shfaqjen e problemeve dhe incidenteve të mëparshme në zgjedhjet lokale. Mospasja e ndalimeve apo penalizimeve në legjislacioni zgjedhor mund të ndikojë në cilësinë e zgjedhjeve por edhe keqpërdorimin e pushtetit nga partitë e fuqishme politike.
3. Në mungesë të një klauzole të ngjashme me atë të nenit 91 për zgjedhjet vendore në Kodin Zgjedhor, është vënë re tendeca e premtimeve të një natyre elektorale nga përfaqësues të qeverisë brenda një intervali kohor mjaft afër me fushatën zgjedhore. Përpos premtimeve, janë ndërmarre edhe hapa konkretë për implementimin e tyre apo edhe investime të caktuara, gjë që jo vetëm krijon një disbalancë për pushtetin midis partive politike me përfaqësuesit e tyre, por mund të ketë influence direkte tek komuniteti dhe votuesit.
4. Alokimi i të ardhurave të shtetit për vitin 2023 për vlerën mbi 1 miliardë lekë ka fokusin tek investimet mbi infrastrukturën dhe energjitikën dhe sigurinë në vend. Pjesa më e madhe e projekteve janë në proces vazhdimi dhe më pak projekte të reja për investim. Ndarja e buxhetit për investime në pushtetin vendor vendos një peshë më të madhe në Tiranë, Berat, Mat, Pogradec dhe Elbasan sakaq Gramshi, Delvina, Durrësi, Fushë- Arrëzi, Shkodra dhe Vora, 0 lekë investime publike.

Rekomandime:

1. Kalimi i Kodit Zgjedhor në një proces të hollësishëm rishikimi për hapësira ligjore nga të cilat partitë politike në fuqi mund të keqpërdorin burimet, influencën apo pushtetin e tyre.
2. Ndryshimi i elementëve ligjor të Kodit Zgjedhor si neni 91, në mënyrë që të jenë përgjithësues për ndalimet e keqpërdorimit të burimeve për proceset zgjedhore, qofshin ato lokale apo vendore.
3. Ndërmarrja e hartimit të pikave të veçanta në nenet e Kodit Zgjedhor që përcaktojnë në mënyrë të detajuar pas një procesi të hollësishëm kërkimor për hapësirat ku ekzekutimi i legjislacionit zgjedhor ka mangësi, cilat janë ndalimet e nevojshme që duhen marre dhe dhënia më tepër pavarësi dhe kompetenca KQZ-së.
4. Ndarja e portofolit investues të buxhetit të shtetit të mos drejtohet nga infrastruktura, energjitika apo siguria vetëm në periudha zgjedhore. Të jepet një vëmendje më e madhe ndaj projekteve të papërfunduara, të ngecur në pritje dhe arsyeve përse vijojnë punën pranë po këtyre periudhave. Izolimi i këtij fenomeni duke u identifikuar dhe denoncuar aktorët kryesorë pranë instancave përkatëse.
5. Procesi i monitorimit të zgjedhjeve nga organizata kombëtarë/ndërkombëtare apo institucione të pavarura të mos ndjekë vetëm partitë politike dhe shpenzimet "zyrtare" të tyre. Investimet në pushtetin vendor apo lokal janë një element tjetër që duhet të ndiqet dhe publiku të informohet më tepër mbi rrugëtimin e taksave të tyre në investimet publike.

Referenca:

Administrata publike prioritet për kredi të buta, nëse largohen, kredia i kthehet në tregtare. (2023, March 31). InFormim. <https://informim.al/administrata-publike-prioritet-per-kredi-te-buta-nese-largohen-kredia-i-kthehet-ne-tregtare/>

FLETORJA ZYRTARE. (2022, December 29). Ministria e Financave dhe Ekonomise. <https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2023/01/AKTI-NORMATIV-NR.19-DATE-29.12.2022.pdf>

Frë and Fair Elections. (2022). Our World in Data. https://ourworldindata.org/grapher/frë-fair-elections-bti?tab=chart®ion=Europe&country=ALB~OWID_KOS~MNE~MKD~SRB~BIH

Kodi Zgjedhor 2020 i ndryshuar. (n.d.). Pamja e dokumentit - Qendra e Botimeve Zyrtare. <https://qbz.gov.al/preview/75122d2e-9ebc-45de-b0ea-b5efde2f6836>

Kongresi i Pare i Shendetesise. (2023, March 6). Ministria e Financave dhe Ekonomise. <https://financa.gov.al/kongresi-i-pare-i-shendetesise-ibrahimaj-do-vijojme-investimet-ne-infrastrukture-dhe-burime-njerezore/>

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË. (n.d.). KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË. <https://klp.al/wp-content/uploads/2020/02/Kushtetuta-2017.pdf>

Ministria e Financave dhe Ekonomise. (2023, February 21). *Permbledhje e te Ardhurave dhe Shpenzimeve per 12-mujorin e fundit.* Ministria e Financave dhe Ekonomise.

<https://financa.gov.al/permbledhje-e-performances-paraprake-12-mujore-te-te-ardhurave-dhe-shpenzimeve-2/>

Rama: Kredi të butë për shtëpi mjekëve specialistë çift! Do paguhen edhe orët shtesë! Qeveria program të posaçëm për të frenuar eksodin. (2023, March 22). Shqiptarja.com.

<https://shqiptarja.com/lajm/rama-do-pergatisim-nje-program-te-posacem-per-mjeket-specialiste-qe-paraqiten-cift-do-i-mbeshtesime-marrje-shtepie>

Rama: Në prill rrisim me 50 mijë lekë pagat e mjekëve specialistë! Nuk finançojmë studentët e mjekësisë që sa të marrin diplomën të ikin në Gjermani. (2023, March 6). Shqiptarja.com.

<https://shqiptarja.com/lajm/rama-ne-prill-rrisim-me-50-mije-leke-pagat-e-mjekeve-specialiste-rritje-me-7-per-pagat-e-mjekeve-te-pergjithshem-dhe-infermiereve>

Spitali i ri Qendror në QSUT, vepra më e madhe infrastrukturore në shëndetësi - ATSH -. (2023, March 25). Agjencia Telegrafike Shqiptare. <https://ata.gov.al/2023/03/25/spitali-i-ri-qendror-ne-qsut-vepra-me-e-madhe-infrastrukturore-ne-shendetesi/>

31 ndryshimet në Kodin Zgjedhor, nga rihapja e kutive deri tek betimi i kryetarëve të partive se nuk do blejnë votat. (2020, June 26). Shqiptarja.com. <https://shqiptarja.com/lajm/31-ndryshimet-ne-kodin-zgjedhor-nga-rihapja-e-kutive-deri-tek-betimi-i-kryetareve-te-partive-se-nuk-do-blejne-votat>

2019 *Elections Report.* (n.d.). OSCE. <https://www.osce.org/search/pages/elections%20albania>

#QËNDRESË MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al